



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:607/25, Datë 02.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Ua 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes 137 të mbajtur më 19.05.2025, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës, Nr.Prot:545/25 e datës 05.05.2025 për ndryshimin e emrit të programit nga Inxhinieri e Mjedisit, në **Inxhinieri e Ambientit BSc 180 ECTS**, program ky i akredituar me vendimin e KShC-së Ref.1383/19 të datës 29.07.2019.
- II. Ndryshohet emri i programit nga Inxhinieri e Mjedisit, në **Inxhinieri e Ambientit BSc 180 ECTS**, akredituar me vendimin e KShC-së Ref.1383/19 të datës 29.07.2019.
- III. Pjesa tjetër e vendimit Ref.1383/19 të datës 29.07.2019 mbetet në fuqi, e pa ndryshuar.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA), me datë 05.05.2025 ka pranuar kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës, Nr.Prot:545/25 për ndryshimin e emrit të programit nga Inxhinieri e Mjedisit, në **Inxhinieri e Ambientit BSc 180 ECTS**, program ky i akredituar me vendimin e KShC-së Ref.1383/19 të datës 29.07.2019.

Ndryshimi bëhet me arsyetimin se gjatë procesit të akreditimit ishte lëshuar si gabim teknik dhe në vend se të shkruhej drejt **Inxhinieri e Ambientit**, ishte shkruar Inxhinieri e Mjedisit.

Po ashtu kërkesës i ishte bashkëngjitur edhe vendimi Nr.829/15 i datës 31.08.2015 me të cilin ky program ishte akredituar me emrin **Inxhinieri e Ambientit BSc 180 ECTS**.

AKA ka proceduar kërkesën për shqyrtim në mbledhjen e 137-të të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, mbajtur me datë 19.05.2025.

KShC ka shqyrtuar dhe verifikuar dokumentacionin e referuar në kërkesë dhe pas analizimit të dokumenteve relevante dhe bazës ligjore, konstatoj se ndryshimi i propozuar i emrit është në harmoni me kriteret e akreditimit dhe rezultatet mësimore të synuara nga ky program.

Andaj KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas administrimit të provave dhe gjendjes së vërtetuar faktike dhe juridike vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.